



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INTEGRIMIT

Plani i Integruar i Ministrisë 2010

Dhjetor 2010



Mesazhi i Ministrit

Gjatë vitit 2010 Ministria e Integrimit do të vazhdojë të udhëheqë progresin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Ky është misioni i madh, objektivi strategjik i Qeverisë Shqiptare, ku unë bëj pjesë, dhe i Ministrisë së Integrimit që unë drejtoj.

Pas hyrjes në fuqi të MSA, procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka hyrë tashmë në një fazë vendimtare. Me vullnetin politik të Qeverisë për të përballuar axhendën e ngjeshur të reformave, Shqipëria ka paraqitur, menjëherë pas hyrjes në fuqi të MSA-së, aplikimin për statusin e vendit kandidat në Bashkimin Evropian dhe aktualisht administrata jonë ka filluar punën për përgjigjet e Pyetësorit të Komisionit Evropian për këtë qëllim.

Integrimi i Shqipërisë në BE tashmë është një proces i mirepritur nga opinioni i gjerë publik (94% e shqiptarëve janë pro integrimit). Në këtë rrugë të gjatë me sfida, të cilën po e përshkojmë me sukses, Shqipëria ka mbështetjen e BE-së gjë që e dëshmon më së miri miratimi së fundi nga ana e Këshillit Evropian të aplikimit të vendit tonë për statusin e vendit kandidat dhe kërkesa Komisionit Evropian për përgatitjen e opinionit (avis) për këtë aplikim. Zgjerimi vazhdon të jete një nga politikat kyç të BE, Qeveritë e vendeve anëtarë të BE-së, së bashku në Këshillin Evropian, kanë rënë dakord të zgjerojnë perspektivën Evropiane tek vendet e Evropës Jug-lindore - një proces gradual i cili i menaxhuar me kujdes krijon një situatë ku të gjitha palët janë fituese.

Reformat për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, për krijimin e një ekonomie funksionale dhe të një sistemi të fortë ligjor të përmirësuar sipas "acquis communautaire" dhe të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirisë së medias, janë siguria për vijueshmërinë e shpejtë të procesit të integrimit.

Vlerësimi që Komisioni Evropian ka bërë deri tani për ecurinë e deritanishme të zbatimit të MSA-së, për reformat rregullatore në fushën ekonomike dhe atë të prokurimeve, është një fakt më shumë që na bën të besojmë se jemi në rrugën e duhur. Klima konsensuale politike në zbatimin e reformave të nevojshme për integrimin e vendit ka çuar marrëdhëniet tona me BE-në në një fazë të re. Ngritja e strukturave të reja si Këshilli i Stabilizimit Asocimit e Komiteti i SA, me hyrjen në fuqinë MSA shënojnë një fazë tjetër drejt integrimit evropian, e cila do të ndërthuret me Aplikimin për anëtarësim në BE dhe hapjen e negociatave për anëtarësimin, një proces i vështirë dhe me sfida të reja.

Unë ndjehem e privilegjuar që koordinoj një proces kaq të rëndësishëm dhe të pakthyesëm siç është ai i integrimit të Shqipërisë në BE. Plotësimi i një pjese të madhe të kriterëve të Kopenhagenit janë dëshmitarë të vendosmërisë tonë për të thelluar reformat duke bashkëpunuar ngushtë me Komisionin Evropian e vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Si përfundim, më lejoni të përmbledh edhe njëherë se hapat e ndërmarra deri tani nga kjo Qeveri dhe mbështetja e siguruar nga Bashkimi Evropian, janë një garanci për një proces të pakthyeshëm e të shpejtë drejt anëtarësimit.

Majlinda Bregu
Ministër i Integritimit

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	5
2	Objektivat Strategjikë të Strategjive Sektoriale dhe Ndërsektoriale të Ministrisë ..	6
3	Programet buxhetore të Ministrisë	8
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010	9
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë	11
Aneks 1	Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2010	12
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian	13
Aneks 3	Investimet publike	15
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	16
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	17

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Integritit ka për mision drejtimin dhe bashkërendimin e procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin European, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European dhe në këtë kuadër hartimit të politikave të integritit, programimin e ndihmës financiare nga Bashkimi European dhe informimit të publikut për këtë proces, si dhe përgatitjen e versionit shqip të *acquis communautaire*. Ajo luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e institucioneve shqiptare për anëtarësim në Bashkimin European, si dhe përfaqëson Qeverinë Shqiptare në marrdhëniet me Bashkimin European.

Ministria e Integritit siguron undëheqjen metodologjike të procesit politik të Integritit European dhe shërben si këshilltare e Qeverisë për këtë proces. Ajo drejton dhe udhëzon ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European si dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit.

Me qëllim zbatimin e detyrimeve dhe reformave të nevojshme që rrjedhin nga MSA, Ministria e Integritit harton dhe rishikon çdo vit Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA, i cili shërben si instrument për monitorimin e progresit drejt anëtarësimit në BE.

2 Dokumentet strategjike të Ministrisë

Dokumenti strategjik më i rëndësishëm që përmbledh detyrimet e të gjithë institucioneve të përfshira në procesin e SA, përfshirë Ministrinë e Integrimit është PKZMSA 2009-14, i miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM 862 datë 22.07.2009. Objektivat dhe politikat për Ministrinë e Integrimit, bazuar në këtë plan janë:

Orientimi, Koordinimi dhe Monitorimi i Procesit të Integrimit Evropian

Objektivi politik

Përsheptimi dhe garantimi i procesit të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), me synim përgatitjen e vendit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, përbën objektivin strategjik themelor për qeverinë dhe shtetin shqiptar. Qeveria synon përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të koordinimit dhe monitorimit të procesit të integrimit evropian, si elementi kyç për të përsheptuar procesin e integrimit në BE. Forcimi i strukturës së Ministrisë së Integrimit përbën një angazhim të vazhdueshëm nga ana e Qeverisë shqiptare për të përballuar kriteret politike, ekonomike dhe legjislative që kërkon ky proces.

Në zbatim të MSA-së, Shqipëria do të përkthejë gjithë legjislacionin e Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe, si dhe anasjelltas. Ky proces i përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian duhet të shkojë paralelisht me procesin e përafrimit dhe të jetë në funksion të rritjes së ritmeve dhe cilësisë së këtij të fundit. Në kuadër të perspektivës së anëtarësimit të Shqipërisë në BE, është e nevojshme që administrata publike dhe të gjitha palët e tjera të interesuara të mund ta përdorin legjislacionin e Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe. Përveç kësaj, duke marrë në konsideratë faktin që gjuha shqipe do të jetë gjuhë zyrtare e BE-së kur Shqipëria të anëtarësohet, i gjithë legjislacioni i Bashkimit Evropian do të duhet të jetë i përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

Për periudhën afatmesme, prioritetet për Ministrinë e Integrimit janë:

- Të orientohen dhe drejtohen politikat shtetërore me qëllim zbatimin e detyrimeve prioritare që rrjedhin nga MSA, duke pasur parasysh përsheptimin e procesit të integrimit si rrjedhim i aplikimit për statusin e vendit kandidat.
- Të koordinohen dhe monitorohen reformat e kërkuara në përputhje me realizimin e detyrimeve të MSA për fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të saj.
- Forcimi i kapaciteteve administrative në funksion të procesit të përkthimit
- Përgatitja dhe botimi i fjalorëve mbi terminologjinë e përkthimit për çështjet specifike
- Ngritja e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar 2007-2013 me qëllim monitorimin e tyre.
- Rritja e kapaciteteve të Ministrisë së Integrimit për të rritur me tej efektivitetin në monitorimin e implementimit të angazhimeve në kuadër të MSA-së;
- Mbështetja për Drejtoritë të Integrimit Evropian, në Ministrinë e Linjës dhe institucione të tjera shtetërore me qëllim funksionimin efektiv të tyre, rritjen e kontributit në procesin e integrimit Evropian;

- Mbështetja e strukturave përkatëse nga niveli më i lartë i ekzekutivit deri në nivelin teknik të ekspertëve, të cilat do përfaqësojnë qeverinë shqiptare në strukturat e përbashkëta BE - Shqipëri (Këshilli i Stabilizim Asociimit, Komiteti i Stabilizim Asociimit dhe Nen-komitetet), të cilat mbikëqyrin zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;
- Rishikimi periodik i Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA-s, me një fokus të veçantë në aspektet që lidhen me afatet e përcaktuara sipas detyrimeve të MSA-së, si dhe adresimin e problematikes dhe rekomandimeve të Raportit Progrosit të Komisionit Evropian;
- Organizimi i strukturave dhe trajnimi i vazhdueshëm i administratës publike për tu përballur me fazat e mëtejshme të aplikimit për statusin e vendit kandidat, si hapja e negociatave për anëtarësim në BE;
- Mbështetja e projekteve në sektorë prioritarë nga programi i asistencës së Bashkimit Europian - IPA, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të zonave kufitare për përfitimin e fondeve të Bashkimit Europian nëpërmjet programeve ndër-kufitare;
- Zbatimi me metodën e decentralizuar të fondeve të asistencës komunitare, komponentët I-V të IPA-s dhe përgatitja për fondet strukturore dhe të kohezionit.
- Bashkëpunimi me vendet e rajonit dhe Kosovën për një përfaqësim të përbashkët drejt BE

Objektivat për vitin 2010

Objektivat prioritarë të përcaktuara për vitin 2010, janë si më poshtë:

- Të orientohen dhe drejtohen politikat shtetërore me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA brenda periudhës së parë 5 vjeçare.
- Të koordinohen dhe monitorohen reformat e kërkuara në përputhje me realizimin e detyrimeve të MSA për fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të saj.
- Krijimi dhe mirëfunksionimi i kuadrit nënligjor për procedurat e realizimit të procesit të përkthimit.
- Krijimi dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative në funksion të procesit të përkthimit.
- Institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me të gjitha grupet e interesit për procesin e përkthimit.
- Të koordinohet puna dhe të ndiqen procedurat për akreditimin e sistemit të menaxhimit të decentralizuar të fondeve të BE.
- Të plotësohen kërkesat për marrjen e statusit të vendit kandidat

3 Programet buxhetore të Ministrisë

Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm

Qëllimi: Mbështetja e ministrive të linjës dhe institucioneve qendore për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga MSA me synim përgatitjen e vendit për marrjen e statusit të vendit kandidat me qëllim final anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Mbështetja Institucionale për procesin e integrimit

Qëllimi: Rritja e ndërgjegjësimit në publik për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i Stabilizim Asocimit, në mënyrë të vecantë ato që rrjedhin nga MSA. Vendorsja/koordinimi i hapave metodologjikë për procesin e përkthimit të acquis në gjuhën shqipe. Rritja e aftësive thithëse të asistencës komunitare nga ana e institucioneve përfituese shqiptare.

Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi

Qëllimi: Përafrimi i legjislacionit dhe i standardeve të tjera me vendet e BE. Reformimi i plotë i strukturës dhe kualifikimi i punonjësve brenda vitit 2011 për t'ju përgjigjur më së miri sfidave të integrimit. Përdorimi sipas programit dhe me efektivitet i vlerave monetare e materiale, duke siguruar që fondet publike të përdoren në përputhje me ligjin dhe politikën e Qeverisë. Ngritja e një sistemi bashkëkohor të IT, përditësimi dhe publikimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së Ministrisë në ëebsite.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010

Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm

1. Mbështetje për zbatimin e MSA
 - Detyrime që rrjedhin nga MSA të përmbushura
 - Plani Kombëtar i zbatimit të MSA i rishikuar
 - Institucionalizimi i strukturave ndërinstucionale, si komitete, nenkomitete dhe grupet ndërminstrore të punës në përputhje me fushat e zbatimit të MSA-së dhe në sintoni me ecurinë e procesit të integrimit.
 - Mbështetje të vazhdueshme për funksionimin dhe monitorimin e rezultateve të drejtorive të integrimit të ministrive të linjës.
 - Adresimi i prioriteteve të reja të dokumentave themelore të BE-së (Raporti Vjetor i Komisionit Evropian 2009) si dhe rekomandimet e takimeve dypalëshe.
2. Përshpejtimi i procesit të adoptimit të *acquis communautaire*, përafrimi i legjislacionit të parashikuar për fushat prioritare të fazës së parë (neni 70)
 - Akte ligjore/nënligjore të certifikuara
3. Forcimi i kapaciteteve profesionale të nëpunësve civilë në ministritë e linjës dhe strukturat zbatuese të ligjit
 - Nëpunës civilë që trainohen nga ITAP për ceshtjet e integrimit në rritje
 - Nëpunës civilë që përfitojnë nga asistenca e TAIEX në rritje
 - Nëpunës civilë të trainuar nga asistenca e projekteve të BE në rritje

Mbështetja Institucionale për procesin e Integrimit

1. Përmirësimi i cilësisë së projekteve të financuara nga asistenca e BE IPA, komponenti i I dhe II duke siguruar një lidhje më të mirë me prioritetet e procesit të SA dhe objektivat e bashkëpunimit rajonal
 - aplikime të përgatitura në kuadër të programimit të IPA, komponenti i I dhe II
 - Projekte të programit CARDS të përfunduara me sukses dhe në kohë
 - Kapacitete administrative të trainuara për projektet financiare të BE
 - Marrëveshje financiare të IPA-s të miratuara
2. Përgatitja e versionit shqip të legjislacionit Evropian dhe përkthimi i legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE
 - 16,000 faqe akte ligjore të BE të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të rishikuara
 - 4,000 faqe të legjislacionit shqiptar të përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të BE
 - Fjalorë terminologjikë të përgatitur për fushat prioritare të *acquis communautaire*;

3. Forcimi i kapaciteteve administrative për përkthimin e legjislacionit
 - Kapacitete administrative të trajnuara për raportimin në procesin e integrimit
4. Ngritja e një sistemi elektronik mbi menaxhimin e procesit të përkthimit
 - Softëare të instaluar për procesin e përkthimit
 - Sistemi elektronik për menaxhimin e procesit të përkthimit
5. Intensifikimi i fushatave informuese rreth procesit të integrimit
 - Qendra komunikimi funksionale
 - Kapacitete administrative të trainuara për raportimin në procesin e integrimit
 - Aktivitete të organizuara për ndërgjegjësimin e publikut

Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

1. Drejtimi dhe koordinimi i veprimtarisë së Ministrisë nga autoritetet kryesore drejtuese për hartimin dhe zbatimin e politikës së Qeverisë në fushën e integrimit European dhe zbatimin e MSA
 - Burime njerëzore, ekonomike-financiare të mirëmenaxhuara, si dhe nevoja logjistike të plotësuara
 - Politika të hartuara, drejtimi teknik si dhe raporte të përgatitura për procesin e integrimit në BE
2. Drejtimi dhe koordinimi i punës së sektorëve të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, parandalimi, kontrolli dhe zgjidhja e gjendjeve të konfliktit të interesit
3. Trainimi i 60% të stafit brenda e jashtë vendit gjatë vitit 2010, përditësimi i database për punonjësit, si dhe mbështetja logjistike për stafin e ministrisë
 - Database i punonjësve i përditësuar, rekrutimet e punonjësve në përputhje me ligjin, si dhe 60 punonjës të trainuar
4. Hartimi i programeve buxhetore afat-mesme dhe vjetore, mirëadministrimi ekonomik e financiar, hartimi i bilanceve periodike e vjetore, prokurimi i fondeve publike sipas buxhetit të miratuar për vitin 2010, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi
 - PBA dhe buxheti vjetor i hartuar, vlera monetare e materiale të mirëadministruara, bilance të hartuara
5. Përditësimi i të dhënave në faqen e internetit, kontrolli dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT-së, internetit, telefonisë fikse dhe energjisë elektrike
 - Faqe interneti e përditësuar, sistemi i IT, energji elektrike si dhe i telefonisë fikse i mirëmbajtur
6. Blerje e pajisjeve për zyra
 - Pajisje të reja zyresh (tavolina, etazhere, karrike, piktura, etj)
7. Blerje e pajisjeve elektrike, elektronike
 - Pajisje elektrike, elektronike
8. Blerje e automjetit të ri për ministrin

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2010.

Treguesit (Emërtimi i treguesit)	Njësia	Sasia (cili është niveli i treguesit që synohet të arrihet për vitin 2010)
Azhornimi i detyrimeve që rrjedhin nga MSA dhe dokumentat e tjerë strategjikë për të gjithë institucionet	Numër planesh strategjike	1 PKZMSA i azhurnuar me rekomandimet e raportit të fundit të progresit të KE
Akte ligjore të propozuara të certifikuara për përputhshmërinë e tyre me acquis	Numër aktesh	300
Monitorimi i zbatimit të PKZMSA dhe përmirësimi i cilësisë së raportimit, i përkthyer në raporte më pozitive të BE.	Numer raportesh, metodologjish, përdorimi i sistemit on-line	1 raport vjetor (2 kontribute), raporte për komitetet, nenkomitetet dhe Këshillin e SA
Koordinimi i procesit të plotësimit të Pyetësorit dhe marrja e statusit të vendit kandidat	Numër kapitujsh të përgjigjur	Pyetësori me 35 kapituj-përgjigjet e 2280 pyetjeve
Përgatitja e versionit shqip të acquis communautaire	Nr. faqesh	16,000
Përkthimi i legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE	Nr. faqesh	4,000
Programi i asistencës komunitare për vitin 2010 dhe 2011 në përputhje me prioritetet e procesit të SA	Nr. programesh	2 paketa vjetore të komponentit I (asistencë teknike për ngritje institucionesh)
Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkuftar; Administrimi i thirrjeve të shpallura dhe shpallja e thirrjeve të reja	Nr. programesh	6 programe në zbatim + programi i ri MED
Ndërgjegjësimi/informimi i publikut për procesin e integritetit European dhe mundësinë e përfitimit nga fondet e BE	Nr. aktiviteteve të informimit	60 (ditë informuese për programet dhe paketën e aplikimit CBC, projekt-fishat e komp.I, ÉBIF, aktivitete të tjera në kuadrin e zbatimit të strategjisë së komunikimit lidhur me aplikimin për statusin e vendit kandidat etj.)
Burime njerëzore të mirëmenaxhuara, stafi i MIE dhe ministrive të linjës i trainuar për ceshtje të integritetit European	Nr. punonjësish	1,600

Aneks 1 Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2010

Nr.	PROJEKTAKTE	OBJEKTI DHE QELLIMI I PROJEKTAKTIT	MINISTRI PROPOZUES	AFATI I PARAQITJES NE KESHILLIN E MINISTRAVE	KOMENTE
1	Projektvendim për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA të ndryshuar	Ka për qëllim përditësimin e detyrimeve të institucioneve shqiptare në kuadrin e zbatimit të MSA, me prioritetet e caktuara në raportin e fundit të progresit të KE	Ministri i Integrimit	Tre-mujori III	
2	Projekt-vendim për miratimin e përgjigjeve të Pyetësorit për anëtarësim	Ka për qëllim konfirmimin e përgjigjeve të përgatitura nga administrata shqiptare	Ministri i Integrimit	Fundi i tremujorit I	
3	Projekt-vendim për miratimin në parim të Marrëveshjes Financiare IPA 2010	Miratimin e financimit të paketës së projekteve IPA 2010 për t'i hapur rrugë zbatimit të tyre	Ministri i Integrimit	Tremujori I	
4	Projekt-vendime për miratimin e Marrëveshjeve financiare vjetore të 7 programeve të bashkëpunimit ndërkufitar	Miratimin e financimit për projektet që përzgjidhen fituese nga thirrjet për propozime të programeve CBC	Ministri i Integrimit	Gjatë 2010	

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian

Rezultatet kryesore që lidhen me Integrimin evropian kanë të bëjnë kryesisht me rolin që ka Ministria e Integrimit në këtë proces: Koordinimi dhe monitorimi i detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integrimit Evropian; kontrolli i përputhshmërisë së legjislacionit vendas me legjislacionin komunitar dhe forcimi i kapaciteteve administrative.

Në mënyrë të vazhdueshme është bërë monitorimi i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA (PKZMSA) dhe përgatitja e progres-raporteve mujore, tremujore dhe raporte vjetore, të cilat raportohen periodikisht pranë Komisionit Evropian dhe palëve të tjera të interesuara. Në këtë kuadër është bërë një vlerësim i zbatimeve të angazhimeve të marra në PKZMSA dhe në bazë të detyrimeve që dalin edhe nga dokumente strategjike integruese është bërë i mundur përditësimi vjetor i PKZMSA, i miratuar me VKM nr. 862 datë 22.07.2009. Në këtë kuadër, Ministria e Integrimit ka vazhduar të aplikojë sistemin *on-line* për monitorimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe është duke përgatitur projektin për përmirësimin e tij dhe integrimin me sistemet e tjera të IT të MIE. Ky sistem, i cili është funksional që prej vitit 2007, ka përmirësuar ndjeshëm koordinimin si dhe do të rrisë cilësinë e raportimit.

Janë zhvilluar periodikisht takimet vjetore të nënkomiteteve të SA të cilat kanë trajtuar progresin e bërë në ecurinë e reformave sipas fushave. Gjatë vitit 2009 u zhvilluan 7 takime të Nënkomiteteve BE-Shqipëri si dhe takimi i Këshillit të SA, në Maj 2009. Këto takime kanë si qëllim monitorimin, rakordimin e zhvillimeve në fushat e mbuluara prej tyre, si dhe shkëmbimin e informacioneve mes palës evropiane dhe asaj shqiptare, me qëllim ecurinë e procesit të integrimit. Në këto takime, ekspertët shqiptarë raportuan për zhvillimet në fushat përkatëse si dhe në kuadër të monitorimit të përmbushjes së angazhimeve nën MSA. Pala evropiane dhe shpjegime dhe njohu palën shqiptare me zhvillimet më të fundit në politikën evropiane për këto fusha.

Me qëllim monitorimin e procesit të detyrimeve që rrjedhin nga MSA, të zbërthyer në iniciativë ligjore dhe aktivitete zbatuese në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, është hartuar progres-raporti për periudhën tetor 2008 - shtator 2009, në kuadër të Kontributit të Qeverisë Shqiptare, për Raportin Vjetor të Komisionit Evropian të publikuar në datën 14 tetor 2009, për vlerësimin e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar puna për certifikimin e përputhshmërisë së akteve ligjore nënligjore shqiptare me aktet komunitare. Harmonizimi i legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian përbën një nga shtyllat më të rëndësishme të procesit të integrimit evropian të vendit. Ekspertët e Ministrisë së Integrimit kanë dhënë opinione ligjore për një numër të konsiderueshëm aktesh normative të fushave të ndryshme. Në funksion të kësaj të fundit është përmirësuar dhe përditësuar edhe baza e të dhënave TAIEK për opinionet ligjore të dhëna nga Ministria e Integrimit për përputhshmërinë e akteve ligjore me *acquis communautaire*.

Ministria e Integrimit në rolin e saj si koordinatore e asistencës komunitare për Shqipërinë, kryen programimin e fondeve IPA, komponenti I dhe II. Gjatë programimit të IPA 2010 është mbajtur parasysh që të financohen projekte prioritare bazuar në programin e Qeverisë dhe prioritetet e procesit të Stabilizim-Asocimit, zbatimit të MSA dhe përgatitjes për aplikimin për anëtarësim. Kjo paketë përmban 10 projekte me një përqendrim krahasimisht të madh të investimeve në infrastrukturë (ujësjellës-kanalizime dhe rrugë).

Ministria e Integrimit është përgjegjëse për programimin dhe zbatimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar IPA: Shqipëri-Mali i Zi, Shqipëri-Maqedoni, Shqipëri-Greqi, IPA

Adriatic dhe SEE. Gjatë vitit 2009 nga të gjitha programet (përveç Shqiperi-Greqi) u lancuan thirrjet për projekt-propozime, të cilat do të vlerësohen gjatë tremujorit të parë 2010.

Gjatë vitit 2009 është plotësuar baza ligjore për përkthimin e *acquis communautaire* dhe është kryer rishikimi i akteve komunitare të përkthyer. Ka filluar procesi i përzgjedhjes së përkthyesve sipas legjislacionit në fuqi për përkthimin e *acquis*, si pjesë e detyrimit për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis*.

Janë zhvilluar disa Seminare, kryesisht mbi Bashkimin Evropian dhe menaxhimin e fondeve të tij si dhe procesin e përafrimit të legjislacionit. Njësitë e integritit të ministrive të linjës, bazuar në VKM Nr.17 datë 7.01.2009 janë ngritur në nivel drejtorie me një staf prej 1+3 personash.

Forcimi i kapaciteteve administrative me qëllim njohjen dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga MSA mbetet një tjetër objektivi i Ministrisë së Integritit. Për këtë qëllim Ministria e Integritit ka punuar për: rritjen e numrit të nëpunësve civilë që trajnohen nga ITAP në bashkëpunim me asistencën e huaj gjermane, spanjolle dhe atë të BE-se; rritjen e numrit të nëpunësve civilë që përfitojnë nga asistencë teknike e TAIEX si dhe rritjen e numrit të nëpunësve civilë që përfitojnë trajnime nga projekte të Bashkimit Evropian.

Me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administratës publike, Ministria e Integritit ka përcjellë pranë shërbimeve të TAIEX nevojat për trajnime të Ministrive të Linjës si dhe ka ndihmuar në vendosjen e komunikimit mes TAIEX dhe Ministrive përkatëse. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur të informuar ekspertët shqiptarë për risitë e programit me synim rritjen e numrit të punonjësve që përfitojnë nga ky program si dhe me aspektet teknike të këtij programi.

Gjatë tremujorit të fundit 2009 është punuar për përgatitjen e kapaciteteve për përgjigjet e Pyetësorit të KE për statusin e vendit kandidat, proces i cili sapo ka filluar dhe pritet të përfundojë në Mars 2010. Në këtë proces kyc për të ardhmen e Shqipërisë, i cili do t'i hapë rrugë negociatave për anëtarësim, është akoma më i rëndësishëm bashkëpunimi i të gjithë institucioneve shqiptare dhe sigurimi i bashkërendimit të punës së tyre.

Aneks 3 Investimet publike

Te paraqitet lista e investimeve publike, me kostot përkatëse që do të kryej ministria për vitin 2010

Emërtimi i projektit të investimit publik	Kosto (në milion lekë)
Blerje automjeti për ministren	8,000
Blerje pajisje zyre	3,000
Blerje pajisje elektrike, elektronike	2,400

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Emërtimi i projektit	Grant/ kredi	Donatori	Vlera e projektit (në mln/lekë)	Plani 2010 (në mln/lekë)
Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e MSA	grant	Komisioni European	2 MEuro	1 MEuro
Mbështetje për përgatitjen e projekteve (PPF)	grant	KE	1 MEuro	0.6 MEuro
Mbështetje për implementimin e programeve CBC	grant	KE	0,520 MEuro	0,250 MEuro
Mbështetje për implementimin e programeve CBC (fondet e AT të 5 programeve)	grant	KE	0,477 MEuro	0,350 MEuro

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Të bashkangjitet Plani i Veprimit Antikorrupsion për vitin 2010 që çdo ministri përgatit në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2007-2013. Për këtë të ndiqet formati i mëposhtëm:

OBJEKTIVAT	MASAT	INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUESE	AFATI I REALIZIMIT	BURIMET E ZBATIMIT	TREGUESIT MONITORUES
Organizimi i procedurave transparente të prokurimit publik	(i) Trainime të specialistëve nga ITAP dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të shërbimit publik	DAP/ITAP	Gjatë 2010	Buxheti i shtetit	Specialistët e ngarkuar me prokurimet të informuar për legjislacionin në fuqi
	(ii) emërimi në njësinë e prokurimit të specialistëve të fushës dhe me eksperiencë		Gjatë 2010	Buxheti i shtetit	Prokurimet në zbatim të ligjit, pa vërejtje nga KLSH
	(iii) përdorimi i tenderit të hapur si procedurë kryesore në prokurime		Gjatë 2010	Buxheti i shtetit	"
	(iv) procedura transparente të publikuara në internet dhe buletinin e prokurimit publik		Gjatë 2010	Buxheti i shtetit	"
Përdorimi me efikasitet dhe transparencë i fondeve buxhetore	(i) respektimi korrekt i planit të buxhetit 2010 të miratuar nga MF (ii) respektimi i ligjeve për pagat dhe shpërblimet (iii) forcimi i disiplinës financiare në përputhje me ligjin 6942 dt. 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare e materiale" (iv) raportimi periodik i performancës financiare të institucionit		Gjatë 2010	Buxheti i shtetit	Raporte pozitive të KLSH mbi realizimin e buxhetit

<p>Zbatimi i procedurave të rekrutimit të punonjësve</p>	<p>(i) zbatimi i legjislacionit të shërbimit civil, rekrutime të kryera me testim ose kontratë të miratuar nga DAP</p> <p>(ii) procedura transparente të publikuara</p> <p>(iii) punësim i ofruar specialistëve që kanë shfaqur aftësitë më të mira</p>		<p>Gjatë vitit 2010</p>	<p>Buxheti i shtetit</p>	<p>Rritja e performancës së administratës së MIE</p>
--	---	--	-------------------------	--------------------------	--